

KONTRIBUTI I TEKNOLOGJISË NË MËSIMIN E LETËRSISË

Dr. Flavia Kaba

Departamenti i Gjuhës Spanjolle
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: flavia.kaba@gmail.com

PËRMBLEDHJE

Në ditët e sotme, ndikimi i teknologjisë informatike dhe të komunikimit po bëhet gjithnjë e më gjithëpërfshirës në shumë fusha sociale. Edukimi dhe njohuria janë baza e zhvillimit njerëzor dhe janë e drejta themelore për çdo qenie njerëzore. Proceset inovative, në ditët e sotme, po bëhen gjithnjë e më shumë përbërës kryesorë të sistemit arsimor pasi studentët, duke qenë se shumica prej tyre janë pjesë e «migrantëve digjitalë», po nxisin pedagogët që të përfshihen në botën e tyre, e cila ndryshon shumë shpejt dhe vazhdimisht. Edukimi fillon nga komunikimi. Brezi i tanishëm i studentëve po kërkon gjithmonë nga pedagogët që të marrin role të reja. Atyre u kërkohet të prezantojnë materialet e reja në një format të ri, më komunikues dhe të drejtpërdrejtë, përmes të cilit mund të jenë të arritshme dhe të shkëmbehen reciprokisht. Në fushën e letërsisë këto sfida forcojnë perspektivën që letërsia është në të njëjtën kohë një vend komunikimi dhe një shprehje e shprehjes artistike e krijuar përmes shkencës së gjuhësisë. Nevoja dhe arsyeja për zbatimin e teknologjisë informative në fushat dhe programet mësimore është të ndihmojmë studentët të bëhen drejtues dhe të suksesshëm në shoqërinë tonë, ku teknologjia po zhvillohet dita ditës. Duke argumentuar se teknologjitë e reja, mund të mbështesin më së miri mësimin e teknologjive të letërsisë në çdo nivel të studimit, pasi ofron shumë mundësi dhe e bën mësimin më produktiv për sa i përket përmirësimeve, artikulli propozon përfshirjen e teknologjive digjitale në literaturën e kurrikulës, duke qenë se teknologjia luan rol shumë të rëndësishëm në një fushë të tillë.

Fjalët çelës: teknologji, letërsi, multimedia, internet, etj.

ABSTRACT

The impact of informatics and communication technology is nowadays becoming more and more inclusive in many social areas. This implementation does not ignore education either. Education and knowledge are the basis of human development and they are the fundamental right for every human being. Innovative processes are becoming the main components of the educational system as students, most of them being «digital migrants», are urging their lecturers to be included in their world, which is quickly and continuously changing. Education starts from communication. The current generation of students is constantly asking lecturers to undertake new roles. They are asked to introduce the new materials in a new format, more communicative and direct, through which they can be accessible and exchanged mutually. In the field of literature these challenges reinforce the perspective that literature is at the same time a place of communication and an expression of artistic expression created through the science of linguistics. The need and reason for the implementation of

information technology in educational areas and curricula is to help students become leaders and successful individuals in our society where technology is being developed day by day. Arguing that new technologies can significantly support the teaching of literature technologies at any level of study, as it provides many options and make teaching more productive in terms of improvements, the article proposes the inclusion of digital technologies in the curriculum's literature, as technology plays a very important role in this field.

Keywords: technology, literature, multimedia, internet, etc.

Hyrje

Jetojmë në një epokë ku teknologjia është shndërruar në një element kulturor të nevojshëm të jetës tonë, e cila po bëhet gjithnjë e më e pranishme dhe e rëndësishme edhe në procesin mësimor. Në përvojën tonë të përditshme dhe veprimtarinë profesionale, dita ditës ndeshemi me shprehjet: «epoka e internetit», «risitë digjitale», «revolucion virtual», shprehje këto më se reale të cilat po shndërrojnë marrëdhëniet njerëzore në mënyrë të vazhdueshme. Në epokën e zhvillimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit, përdorimi i kësaj teknologjie gjatë procesit mësimor është bërë një domosdoshmëri si për pedagogët, ashtu edhe për studentët. Nëse do të kthehemi pas në kohë, para shekullit të XX, të gjithë e dimë se mjetet kryesore të orës mësimore ishin mësuesi, teksti shkollor dhe dërrasa e zezë. Dhe nëse do të analizojmë mjetet personale që përdorim për të shkruar, edhe këto, sigurisht, kanë pësuar ndryshime duke filluar nga penat me bojë deri te makina e shkrimit për t'i zëvendësuar sot me butonat digjitale.

Andaj mund të themi se në ditët e sotme teknologjia e internetit nuk duket se ka lënë ndonjë sektor të jetës pa e përfshirë. Arsimi është pa diskutim një ndër sektorët e përfshirë, i cili tashmë nuk mund të mendohet jashtë vorbullës së teknologjisë apo epokës digjitale. Kësisoj nuk është aspak rastësi që teknologjia dhe digjitalizimi të jenë dita ditës edhe më shumë pjesë e auditorit, ky i fundit në rolin e kanalit të përshtatshëm për të përthithur sa më mirë dhe normalizuar këtë lidhje të domosdoshme, e cila me shumë gjasa, në epokën që jetojmë ka premisa të jetë edhe e pandashme në vijimësi.

Sot, nëpër auditore, pedagogëve u kërkohet që materialet mësimore t'i paraqesin në një format tashmë të ri, komunikues, por edhe dialogues, nëpërmjet të cilit ato të mund të aksesohen dhe shkëmbehen në mënyrë sa më të lehtë. Në

fushën e letërsisë këto sfida përforcojnë premisën që letërsia është njëkohësisht mjet komunikimi dhe një mënyrë shprehjeje artistike e krijuar nëpërmjet shkencës së gjuhësisë. Duke dialoguar, pedagogët përcjellin njohuri dhe marrin reagime nga studentët, më pas këto njohuri të pasuruara i rikthejnë përsëri tek ata duke krijuar cikle të plota shkëmbimi.

Në mënyrë të vazhdueshme, bashkëbisedimet shtrihen përtej orëve të mësimit nëpërmjet forumeve në të gjitha llojet e mediave. Teknologjia përbën një pjesë integrale të jetës së studentëve, për këtë arsye ata kërkojnë ta gjejnë atë edhe në procesin mësimor. Si pasojë stafi akademik ka filluar të hartojë programe mësimore që ofrojnë shumëllojshmëri didaktikash. Aktivitete në komunitet, projekte në grupe, platforma online dhe strategji të tjera mësimdhënieje që motivojnë studentët që të studiojnë në mënyra të përafërta me preferencat e tyre individuale. Në këtë skenar, futja e teknologjisë në programet mësimore nuk paraqet më një zgjedhje, por një domosdoshmëri, një mjet shumë të rëndësishëm si për studentët, ashtu edhe për stafin akademik.

Kontributi i teknologjisë në mësimin e letërsisë

Objekti kryesor i një pedagogu letërsie është të ndihmojë studentët në studimin apo kërkimin e pasurive të teksteve letrare në lidhje me tekste dhe përmbajtje kulturore, duke qenë se ende pedagogu shihet si një burim informacioni aktiv dhe studenti luan rolin pasiv të grumbullimit dhe përsëritjes të informacionit të marrë. Gjetja e informacionit, pyetjeve të hapura, lidhjeve dhe përmbajtjeve mund të bëhet fare lehtë nëpërmjet kompjuterit, duke i dhënë kështu mundësinë studentëve të aksesojnë një numër materialesh sipas dëshirës dhe për më tepër të grumbullojnë dhe të shtojnë në to shënimet e tyre. Një vend të rëndësishëm në kontributin e teknologjisë në mësimin e letërsisë e zënë edhe adresat e ndryshme të internetit apo faqe të ndryshme web të kritikëve letrarë, lëvizjeve letrare etj., të cilat u ofrojnë studentëve por sigurisht edhe pedagogëve interpretime apo vlerësime kritike letrare dhe recensione. Disa nga këto faqe interneti që mund t'u ofrohen studentëve janë Qendra Virtuale Cervantes (El Centro Virtual

Cervantes),¹ ku ofrohen publikime shkencore apo seksione kushtuar autorëve ku mund të gjendet informacion i saktë dhe i bollshëm mbi veprat letrare dhe autorët. Qendra Virtuale Cervantes, në seksionin e Letërsisë, ofron një gamë të gjerë informacioni në lidhje me letërsinë që mund të jetë me shumë përfitime gjatë orës së letërsisë.² Një tjetër adresë e cila ofron informacione të shumta letrare është <http://ciudadseva.com/biblioteca/indice-autor-cuentos/>, <http://www.lecturalia.com/portada/premios-literarios>³ apo <http://www.worldliteraryatlas.com/es>⁴ etj. Të tilla adresa interneti dhe faqe web ndihmojnë studentët jo vetëm të lexojnë punimet më bashkëkohore mbi letërsinë spanjolle, por edhe punime shkencore si akte konferencash, botime artikujsh, recensa, kritika letrare etj.

Një interes të jashtëzakonshëm ofrojnë bibliotekat virtuale dhe projektet e ndryshme qëllimi i të cilave është të bëjë të aksesueshme ose të lehtësojë aksesin në veprat letrare (si edhe në tekste të tjera) për publikun, me një mundësi përhapjeje që kurrë më parë nuk ishte ofruar. Që nga Projekti Gutenberg (<http://www.gutenberg.org>), i cili filloi në vitin 1971 me aplikimin e teknologjisë digjitale asokohe dhe që aktualisht ka 50,000 vepra me akses të lirë.⁵ Në fushën hispanike duhet pasur parasysh prestigjiozja Biblioteka Virtuale Miguel de Cervantes, e Universitetit të Alicante-s,⁶ i cili, përveç katalogut të librave, ka një fonotekë, sallë gazetash, arkiva digjitale të tezave të doktoraturës nga universitete të ndryshme spanjolle dhe të huaja etj. Në mesin e bibliotekave dedikuar letërsisë në një gjuhë konkrete, do të theksoj për organizimin e tij, përveç shpërndarjes kronologjike të autorëve, të dhëna të tilla si origjinën gjeografike, Digitale Bibliotheek voor de Nederlandse Letteren (<http://www.dbnl.nl>). Me interes të madh është edhe Google Book Search (<http://books.google.com>), i cili lejon hyrjen në libra të plotë ose pjesë të librave.⁷

1 <http://cvc.cervantes.es>

2 Lopez Moyano, Juan Carlos, *Reflexiones sobre el uso de la literatura en clase de ELE*, fq. 80

3 <http://ciudadseva.com/biblioteca/indice-autor-cuentos/>, <http://www.lecturalia.com/portada/premios-literarios>

4 <http://www.worldliteraryatlas.com/es>

5 <https://web.archive.org/web/20170225103832/http://www.gutenbergnews.org/20151003/project-gutenberg-releases-ebook-50000/>

6 <http://www.cervantesvirtual.com>

7 Albaladejo, Tomás, *Literatura y tecnología digital: producción, mediación, interpretación*. http://www.cervantesvirtual.com/obra-visor/literatura-y-tecnologa-digital-produccion-mediacion-interpretacion-0/html/02485b9e-82b2-11df-acc7-002185ce6064_2.html

Duke qenë se teknologjia ka fuqinë ta shndërrojë mjedisin arsimor jo vetëm duke ndihmuar pedagogët që të shkëmbejnë ide dhe eksperiencë, por edhe duke u krijuar studentëve mundësinë për të fituar një shkallë më të lartë kontrolli mbi procesin mësimor, sigurisht që nuk mund të mos ndalemi të kontributet apo përparësitë e teknologjisë në mësimin e letërsisë. Nga përvoja profesionale do të rendisim disa prej këtyre përparësive si më poshtë vijon:

- Teknologjia ndihmon në zhvillimin e të gjitha aftësive gjuhësore si leximi, dëgjimi, shkrimi dhe e folura.
- Teknologjia ndihmon në shfrytëzimin e një morie burimesh referenciale të cilat lehtësojnë procesin mësimor. Studenti mund të aksesojë në platforma të shumta dhe të ndryshme digjitale për të pasuruar kërkimin e tij dhe për të plotësuar boshllëqet që mund të ketë.
- Teknologjia ndihmon në nxitjen e komunikimit ndërgjuhësor dhe atë ndërkulturor. Ndërlidhja e fushave tekstuale dhe audiovizuale gjeneron produkte të reja kulturore duke krijuar një bashkëveprim të ri midis kulturave në epokën digjitale. Procesi ka një vlerë ndërkulturore në vetvete pavarësisht nga mjetet që përdoren dhe përmbajtja që mund të përcillet.
- Teknologjia ndihmon në riprodhimin e njohurive. Studenti është në gjendje të grumbullojë, prodhojë dhe të shpërndajë informacionin e marrë madje shpeshherë në rolin e një eksperti.
- Teknologjia ndihmon në njohjen dhe menaxhimin e bibliotekave digjitale online ku studenti mëson të kërkojë libra, recensione, video etj., duke e ndihmuar atë të eksplorojë adresën interneti të cilat nuk vizitohen shpesh nga vetë ata.
- Teknologjia ndihmon në shfletimin e buletineve letrare elektronike, analizave të veprave letrare apo përmbledhjeve të leksioneve mbi letërsinë, të cilat ndihmojnë studentin të përgatitet paraprakisht për orën e mësimin.
- Teknologjia ndihmon në motivimin dhe në formimin e lexuesve, por gjithashtu i ndihmon ata të marrin kënaqësi nga leximi i teksteve duke zhvilluar botën e tyre emocionale apo duke pasuruar imagjinatën e tyre

për botën që i rrethon. Njëkohësisht nxit dëshirën dhe kuriozitetin e studentëve për t'u bërë jo vetëm lexues aktivë dhe të pavarur, por dhe shkruar të saktë e krijues.

- Teknologjia ndihmon në dizenjimin e aktiviteteve të ndryshme letrare me qëllimin për të shkundur studentët nga rutina e auditorit.
- Teknologjia ndihmon në nxitjen e kreativitetit narrativ.
- Teknologjia ndihmon jo vetëm në njohjen e shkrimtarëve dhe veprave të tyre, por edhe u ofron studentëve mundësinë për të krijuar lidhje nëpërmjet rrjeteve sociale si Facebook, Twitter, Instagram, LinkedIn, apo t'u dërgojnë këtyre shkrimtarëve e-mail-e për të marrë më shumë informacion mbi ata dhe punën e tyre artistike, qofshin këto intervista apo sugjerime si pjesë të ndonjë projekti letrar.

Sigurisht që kontributet e teknologjisë në mësimin e letërsisë nuk favorizojnë vetëm studentët, por pa dyshim edhe stafin akademik. Përfshirja e teknologjisë ose përdorimi i saj në auditore ka ndihmuar dukshëm duke i nxitur studentët të aktivizohen dhe ta ndiejnë veten pjesë të auditorit. Sigurisht që një ndryshim pozitiv ka pësuar edhe raporti mësimdhënës - student, duke i afruar ata më shumë dhe duke i bërë protagonistë deri diku të barabartë në marrjen dhe shpërndarjen e informacionit. Si ka ndodhur kjo? Tashmë në auditorët digjitalë mjetet shkollore si lapsa, gomë, stilolapsa apo fletore shënimesh janë zëvendësuar me laptop, notebook, Smartphone, iPad, iPod, etj., dhe në vend të detyrave të shtëpisë me shkrim studentët u dërgojnë pedagogëve detyrat në adresat e tyre elektronike, sikurse anasjelltas, pedagogët u dërgojnë studentëve materiale shtesë për orën e mësimin. Bashkëbisedimet gjatë orëve shtrihen përtej auditorit nëpërmjet forumeve apo platformave të tjera të komunikimit duke ndihmuar kështu plotësimin e kursit të studimit edhe jashtë ambienteve të auditorëve. Duke siguruar informacione, pyetje të hapura, lidhjet dhe kontekstet mund të bëhen në mënyrë shumë efektive me kompjuter, duke lejuar studentët të aksesojnë në një pasuri materialesh sipas dëshirës, madje edhe duke mbledhur dhe shtuar edhe shënimet e tyre. Një pedagog mund të dërgojë në mënyrë elektronike tekste, materiale mësimore, të ofrojë “perla” për studentët që të shfletojnë dhe të studiojnë. Në veçanti, shtimi i teksteve letrare duke i kthyer ato në hipertekste

studimore, duke futur shënime (që përmbajnë informacione, pyetje të hapura, ide) dhe lidhje (për materialet përkatëse, përfshirë tezat e studentëve dhe transkriptet e diskutimit), paraqet materialin në mënyrë shumë efektive, duke ofruar zgjedhje që stimulojnë mendimin dhe inkurajojnë lidhjet. Në të vërtetë, shpesh dëgjoj studentët që i quajnë këto materiale *hypertext* “ndihmë” dhe përpjekjet e tyre “zbulim”, dy fjalë të dashura për zemrën e çdo mësuesi.⁸

Më poshtë do të rendisim disa nga adresat digjitale letrare që u mundësohen studentëve për konsultë, grumbullim apo nxjerrje informacioni gjatë orës mësimore të letërsisë:

➤ <http://bib.cervantesvirtual.com/seccion/literatura/>
(Biblioteka Virtuale Miguel de Cervantes). Kjo adresë u ofron studentëve, por edhe pedagogëve një mori veprash të digjitalizuara të gjinive të ndryshme letrare. Romane, kritikë letrare, recensione, etj., të gjitha këto në katalogun e letërsisë spanjolle dhe hispanoamerikane.

➤ <http://www.lecturalia.com/portada/premios-literarios>
(Lecturalia: Çmimet letrare në gjuhën spanjolle). Kjo adresë ofron 84.863 libra, 18.483 shkrimtarë dhe 66.986 përdorues të regjistruar.

➤ <http://www.cervantesvirtual.com/bib/portal/literaturaelectronica/index.jsp>
(Letërsi Elektronike Hispanike). Kjo adresë është pjesë e seksionit të Bibliotekës Virtuale Miguel de Cervantes, ku ofrohen vetëm veprat që ekzistojnë në Cyberspace. Këtu shfaqen shumëllojshmëri të galaktikës Gutenberg: multimedia novels, webnovels, hypernovelas, blognovels, etc.

➤ <http://pares.mcu.es/>
(Portal i Arkivit Spanjoll). Kjo adresë është një projekt i Ministrisë së Arsimit, Kulturës dhe Sportit, e cila ka për qëllim përhapjen në Internet të Trashëgimisë Historike Dokumentare Spanjolle.

➤ <http://www.iilionline.org>

8 Woodlief Ann, A Community of Learners: Teaching Literature Electronically, <https://archive.vcu.edu/english/engweb/webchap.htm>

(International Institute of Ibero-American Literature). Kjo adresë ofron botime të Kongreseve të Institutit në prestigjiozen Revistë Iberoamerikane dhe të serive të saj editoriale.

➤ <http://www.bartleby.com/>

(Bartleby.com: Great Books Online). Kjo adresë ofron dhe lejon kërkimin e enciklopedive të ndryshme duke rikuperuar tekstin e plotë në vepra referimi të subjekteve të ndryshme, si dhe në antologjitë e veprave në prozë dhe poezi.

Krahas këtyre adresave të aksesueshme në internet të cilat u mundësohen studentëve gjithashtu ekzistojnë edhe blogje, ndryshe të njohura si «*blogje edukative* ose *edublogs*» ku si studentët, ashtu edhe pedagogët mund të jenë aktivë dhe të kenë përfitime të ndryshme. *Edublog* është një blog, i cili përdoret me qëllime edukative si për mësimdhënësit, ashtu edhe për studentët. Të tilla blogje edukative përveçse i japin lëndës ngjyrimë zbavitëse ndihmojnë edhe në motivin e studentit. Përdorimi i një blogu i lejon studentët të përballen çdo ditë me aktivitete të ndryshme. Si për shembull: të hënën, me një version muzikor të poezisë; të martën, me një koment mbi një vepër letrare e kështu me radhë, duke parashikuar një ditë të caktuar edhe për kontributet e studentëve. Ky qëndrim pozitiv ndaj kësaj lënde gjithashtu favorizon një pjesëmarrje më të madhe në klasë.⁹

Duke qenë se përdorimi i blogjeve është përhapur shumë, por edhe zhvilluar duke ndihmuar kështu të jetë pjesë e rëndësishme e ciklit mësimor më poshtë do të flasim shkurtimisht për llojet e blogjeve dhe funksionin e tyre krahas përfitimeve të shumta që ofrojnë:

Blogu i profesorëve: janë blogje të krijuara nga vetë mësimdhënësit me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe ideve, këshillave dhe përsiatjeve mbi metodologjitë edukative, duke ndihmuar kështu njëri-tjetrin në përmirësimin e mësimdhënies, për të mësuar më shumë dhe për të edukuar më mirë. Të tilla blogje janë të aksesueshme për të gjithë komunitetin edukativ. Disa nga këta blogje janë: <http://manolo-claselengua.blogspot.al/>, <http://www.repasodelengua>.

9 <https://reunir.unir.net/bitstream/handle/123456789/2323/martinez-prieto.pdf?sequence=1>

[com/](#), <http://tecnomapas.blogspot.al/>, <http://depoetasypiratas.blogspot.al/>, <http://fernandotrujillo.es/>

Blogu i profesorëve dhe studentëve: janë blogje të krijuara nga mësime dhënësit dhe studentët me qëllim për të diskutuar përtej dhe jashtë auditorit. Ndër aktivitetet e tjera studentët kanë mundësinë të shprehin vështirësitë dhe problemet e tyre të cilat gjejnë zgjidhje pasi konsultohen me pedagogët. Në të tilla blogje kolektive funksioni i studentit është parësor. Disa nga këta blogje janë: <http://barbarauniversal.blogspot.al/>, <http://clasesmarian.blogspot.al/>, <http://elenigmadelasletras1.blogspot.al/>, <http://jlesolengua.blogspot.al/>.

Blogu i studentëve: janë blogje edukative ku studentët zhvillojnë aktivitete të ndryshme duke stimuluar kështu shkëmbimin e ideve dhe shfrytëzimin dhe investigimin e burimeve të ndryshme të informacionit. Në të tilla blogje studentët përpos shkëmbimit të njohurive dhe eksperiencave bashkohen edhe për të bashkëpunuar në grup për detyrat e ndryshme të dhëna nga ana e pedagogut por edhe për të hartuar projekte mësimore. Disa nga këta blogje janë: <http://blogdeliteraturaparaestudiantes.blogspot.al/>, <http://dueloliterae.blogspot.al/2009/10/mitos-inventados-por-alumnos.html>, <http://institutdesils.cat/mod/url/view.php?id=8879>.

Auditori i digjitalizuar, bashkëpunimi mësime dhënë – student.

Në këtë epokë digjitale ku shpesh dëgjojmë se ka një rënie të numrit të të rinjve që lexojnë letërsi atëherë le të përfitojmë nga implementimi i teknologjisë në orën e letërsisë për të nxitur kështu, nëpërmjet aktiviteteve apo planifikimeve letrare, leximin e sa më shumë veprave letrare. Të tilla aktivitete ndikojnë jo vetëm si faktor motivues dhe nxitës, por edhe si faktor krijues letrar. Aktivitetet letrare mund të jenë të shumta duke nisur që nga planifikimi i një projekti letrar, leximi dhe komentimi i teksteve online, diskutimet letrare, leximi dhe interpretimi i poezive, shkrimi apo hartimi i eseve etj. Aktivitetet mund të organizohen në mënyrë individuale, por edhe në grup. Të tilla aktivitete letrare interaktive ndihmojnë në një bashkëpunim më të mirë midis studentëve duke i nxitur ata drejt të mësuarit bashkëpunues. Krahës këtij bashkëpunimi nuk duhet harruar edhe bashkëpunimi mësime dhënë – student, si çelësi kyç për mirëorganizimin dhe mbarëvajtjen e orës mësimore. Tashmë me

përdorimin e teknologjisë të dyja palët kanë detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në këtë hapësirë digjitale, pavarësisht pengesave apo problemeve që mund të hasen. Sikurse u renditën edhe më lart kontributet e teknologjisë gjatë orës mësimore të letërsisë janë të shumta. Përfitimet që teknologjia ofron në ditët e sotme nëpër auditorë kanë përmirësuar si mësimdhënien ashtu edhe mësimnxënien. Angazhimi për të mirëpritur në të gjitha format e mundshme zhvillimin e teknologjisë dhe zbatimin e saj në orën mësimore ka qenë dhe është i dyanshëm. Ky lloj bashkëpunimi ndihmon në perceptimin më të saktë të teknologjisë edhe pse shpeshherë nuk mungojnë rastet e keqinterpretimit apo keqpërdorimit të saj. Dita ditës nga përdorimi i teknologjisë dalin në pah probleme me keqpërdorimin apo edhe interpretimin e saj. Disa nga këto probleme që hasen mund të jenë:

- Shpërqendrimi i studentëve nga përdorimi i videove, celularëve, internetit, etj.
- Mosdija e studentëve për të kërkuar në internet ose mungesë e mënyrës së të kërkuarit siç duhet dhe në adresat që duhet.
- Burime jo të sigurta interneti ose adresa me informacion të paktë dhe çorientues, të cilat çojnë në keqinterpretimin e informacionit.
- Rënia pre e plagjiaturës, me ose pa ndërgjegje.
- Krijimi i varësisë së tepruar duke devijuar kështu nga qëllimi kryesor i përdorimit të teknologjisë.

Duke pasur parasysh të tilla probleme, nuk duhet harruar roli parësor që ka mësimdhënësi në shpjegimin e qartë të përdorimit të teknologjisë. Ai është mentori që duhet të udhëheqë në rrugën e drejtë për të devijuar nga disa probleme të pashmangshme që ofron teknologjia duke nisur me adresimin e saktë të faqeve të internetit që duhet të përdorin, motivimin për të lexuar më shumë, por edhe se si të përfitojnë sa më shumë dhe më mirë gjatë hulumtimeve të tyre. Përmes orientimit dhe monitorimit të vazhdueshëm, mësimdhënësi ka si një nga objektivat e tij, t'i ofrojë studentit mjetet dhe udhëzuesit që e ndihmojnë atë në zhvillimin e procesit të tij të të nxënies, në të njëjtën kohë që të ndjekë dyshimet dhe të plotësojë nevojat e tij: mësuesi do të pushojë së qeni burim i informacionit, për t'u shndërruar në një lehtësues të të nxënies, duke ndryshuar rolin e tij të mësimdhënies gjatë orës së mësimin, për t'u shndërruar në një udhërrëfyes apo një partner në të gjithë procesin

e nxënies, duke udhëhequr studentin përmes materialeve, debateve, forumeve, në një vlerësim të vazhdueshëm të aktiviteteve të kryera individualisht ose në grupe, duke u bazuar në mjete të shumta elektronike të ofruara nga kampusi virtual.¹⁰ Bashkëpunimi mësimdhënës – student shtrihet edhe përtej auditorit dhe këtu i referohemi komunikimit të tyre nëpër blogjet e krijuara nga ata vetë apo edhe shkëmbimit të mesazheve në adresat elektronike. Një format i tillë bashkëpunimi ndihmon të dyja palët jo vetëm për perceptimin dhe përdorimin sa më të saktë të teknologjisë gjatë orës së mësimi, por edhe për një integrimin sa më bashkëkohor tashmë në të tilla ambiente ku teknologjia bën pjesë.

Përfundime

Sot mund të themi me bindje se koha e mësimdhënies së letërsisë bazuar vetëm në tekstin letrar po mbaron. Është e vërtetë që mësimdhënia e letërsisë në botën e sotme, të dominuar nga teknologjia dhe multimedia, po bëhet gjithnjë e më tepër e ndërlikuar. Por në të njëjtën kohë burimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit mund të jenë zgjidhja ndaj sfidave me të cilat duhet të përballen pedagogët, në mënyrë që të përfshijnë dhe motivojnë studentët e tyre në studimin e letërsisë.¹¹ Impakti i teknologjisë ka ndryshuar rrënjësisht jo vetëm marrëdhënien mësimdhënës – student, por edhe gjithë shoqërinë. Nga ky ndryshim duket se brezi i ri, ku u referohemi studentëve, është përshtatur më shpejt dhe më mirë ndaj hapësirës teknologjike si brenda, ashtu edhe jashtë auditorit. Përparësitë e përdorimi të teknologjisë gjatë orës mësimore janë të shumta, por nuk duhen lënë mënjanë dhe disavantazhet për të cilat, pa dyshim, ekziston edhe një zgjidhje. Sikurse u tha edhe më lart kontributet e teknologjisë nuk favorizojnë vetëm studentët, por edhe stafin akademik për aq kohë sa të tilla teknologji përdoren në mënyrën më të mirë të mundshme. Në këtë epokë digjitalizimi marrëdhënia me teknologjinë dhe përdorimi saj gjatë orës së mësimi tashmë është kthyer në një rit të domosdoshëm si për mësimdhënësit ashtu edhe

10 <https://www.ceipa.edu.co/lupa/index.php/lupa/article/view/63/118>

11 Kaba, F. Teaching and Studying Literature in the Digital Era – From text to Hypertext, <http://turkophone.dergipark.gov.tr/download/article-file/354651> ISSN:2148-6808

për studentët. Duke qenë se letërsia është e lidhur ngushtë me shoqërinë atëherë edhe implementimi i teknologjisë në këtë orë mësimore ka gjetur vend dhe hapësirë duke ndihmuar kështu si studentët në nxënie të kësaj lënde, ashtu edhe mësimdhënësit në përçimin e dijeve. Si përfundim, me përdorimin e teknologjisë të dyja palët kanë detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre në këtë hapësirë digjitale, pavarësisht pengesave apo problemeve që mund të hasen, por ata, natyrisht, i bashkon qëllimi i përbashkët për të ndihmuar njëri tjetrin që të përshtaten sa më shumë e sa më mirë me këtë epokë digjitale.

BIBLIOGRAFIA:

- ALBALADEJO, T., *Literatura y tecnología digital: producción, mediación, interpretación*, http://www.cervantesvirtual.com/obra-visor/literatura-y-tecnologa-digital-produccion-mediacion-interpretacion-0/html/02485b9e-82b2-11df-acc7-002185ce6064_2.html
An Introduction to Benito Pérez Galdós and The Pérez Galdós Editions Project <http://gep.group.shef.ac.uk/intro.htm>
- BHARAT, R.G. Assistant Professor, Department of English, Bhonsala, Military College, Rambhoomi, Nashik (MS) *Impact of technological advancement on literature* (New Man International Journal of Multidisciplinary Studies) < <http://www.newmanpublication.com> >
- HENDERSON, B. (2011), *Books Without Batteries: The Negative Impacts of Technology*, <http://www.publishersweekly.com/pw/by-topic/columns-and-blogs/soapbox/article/46793-books-without-batteries-the-negative-impacts-of-technology.html>
- KABA, F. *Teaching and Studying Literature in the Digital Era – From text to Hypertext*, <http://turkophone.dergipark.gov.tr/download/article-file/354651> ISSN:2148-6808
<https://www.ceipa.edu.co/lupa/index.php/lupa/article/view/63/118>
- MARY, K. Pratt *HoW Technology Is Changing What We Read*, http://www.pcworld.com/article/164355/e_books.html
- PAMELA, DELOATCH, (2015) – *The Four Negative Sides of Technology*, <http://www.edudemic.com/the-4-negative-side-effects-of-technology/>
- SARAH, P. *Humanities Computing Development Team, University of Oxford - Introduction: technology in teaching literature and culture: some reflections* (Teaching European Literature and Culture with C C IT - CTI Centre for Textual Studies) <http://users.ox.ac.uk>
- SHMYALEE, D.S. *Use of Technology in English Language Teaching and Learning: An Analysis*. <http://www.ipedr.com/vol33/030-ICLMC2012-L10042.pdf>
- The Impact of Digital Technologies on Teaching and Learning in K-12 Education - Research and Literature review - Final Report*
http://www.ndlm.edu.au/verve/resources/impact_digital_technologies_k-12pdf.pdf
- WOODLIFE, A., *A Community of Learners: Teaching Literature Electronically*, <https://archive.vcu.edu/english/engweb/webchap.htm>,
<https://reunir.unir.net/bitstream/handle/123456789/2323/martinez-prieto.pdf?sequence=1>